

DEKRET
Nr. 457, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

**Dhënien e dekoratës “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”
zotit Edor Kabashi**

“Në vlerësim të arritjeve shumë premtuese në aspektin inovativ të kërkimit akademik ndërkombëtar në biologji dhe neuroshkenca, fryt i një talenti të spikatur dhe i një pune shembullore që ndikon drejtpërdrejt në përpjekjen për përmirësimin e kushteve të jetës së njerëzimit dhe nxit brezat e rinj, në Shqipëri dhe në diasporë, t’i kushtohen me guxim përsosjes së formimit akademik dhe ekselencës profesionale”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj